V E N D I M
Nr.53, datë 4.2.1999

PËR CAKTIMIN E ZONAVE KUFITARE, LLOJIN E ARMËS, SASINË E MUNICIONEVE, KRITERET E DHËNIES SË LEJES PËR MBAJTJE ARME DHE TARIFAT PËRKATËSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 16 shkronja "b" dhe 17 të ligjit nr.8388, datë 5.8.1998 "Për grumbullimin e armëve dhe municioneve luftarake", me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Zonat kufitare që paraqesin probleme për rendin dhe sigurinë publike të jenë fshatrat e para në afërsi të vijës kufitare, të përcaktuara në lidhjen nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të pajisë me leje për mbajtje arme banorët e zonës kufitare, mbi bazën e kërkesës me shkrim, drejtuar organeve të rendit publik.

3. Për raste të veçanta dhe situata të rënda në zonat kufitare, Ministri i Rendit Publik ka të drejtë të bëjë ndryshime në lidhjen nr.1 të këtij vendimi.

4. Të pajisen me leje për mbajtje arme personat fizikë që banojnë në zonat kufitare të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilët plotësojnë kërkesat e përcaktuara në nenin 9 të ligjit nr.7566, datë 25.5.1992 "Për armët", të kenë kryer shërbimin ushtarak, të kenë mbushur moshën 22 vjeç, të mos kenë të meta mendore e fizike, të mos kenë qenë të dënuar më parë për vepra penale.

5. Banorët e zonave kufitare paraqesin kërkesën për pajisjen me leje për mbajtje arme në komisariatin e policisë, shoqëruar edhe nga këto dokumente:

- Certifikatë lindje, lëshuar nga zyrat e gjendjes civile.
- Vërtetim që kanë kryer shërbimin ushtarak nga dega ushtarake.
- Vërtetim nga organi mjeko-ligjor se personi nuk vuan nga ndonjë sëmundje mendore.
- Dëshmi penaliteti.
- Vërtetim lëshuar nga këshilli i komunës ku banojnë, i cili vërteton se personi është banor i komunës.

6. Pas paraqitjes së kërkesës, nëse personi mban armë pa leje, komisariati i policisë e pajis atë me një leje armëmbajtjeje të përkohshme, deri në marrjen e përgjigjes përfundimtare nga ky komisariat, e cila ka afat jo më të gjatë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës.

7. Banorëve të fshatrave të zonës kufitare u lejohet të regjistrojnë dhe të pajisen me leje për mbajtje armë krahu, pushkë ose automatik.

8. Leja për mbajtje arme, dhënë nga organet e rendit publik është individuale dhe jepet vetëm për një armë.

Dhënia e lejes kolektive për mbajtje arme ndalohet.

9. Sasia e municionit për çdo armë të dhënë me leje të jepet:

- për pushkën100 copë fishekë
- për automatikun deri në200 copë fishekë

10. Banorët e fshatrave të zonës kufitare, të pajisur me leje për mbajtje arme, kanë të drejtë të qarkullojnë me armën e dhënë, vetëm brenda territorit të zonës kufitare ku ato banojnë, me përjashtim të rasteve kur banori kërkohet të paraqitet në organin e rendit publik, i cili e ka pajisur me leje.

11. Për çdo armë të dhënë me leje, të regjistruar, të zbatohen këto tarifa:

- Për banorët e fshatrave të zonës kufitare100 lekë në vit
- Çmimi i lejes për mbajtje arme430 lekë

12. Në rast humbjeje, vjedhjeje, grabitjeje të armëve të dhëna me leje, shtetasit, banorë të zonave kufitare, janë të detyruar të bëjnë kallëzim në organet kompetente brenda 24 orëve nga momenti i konstatimit.

13. Përbërja e komisionit të shqyrtimit të kërkesave, rregullat dhe kërkesat për regjistrimin, grumbullimin, dorëzimin vullnetar e të detyrueshëm të armëve e municioneve luftarake, dhënia e lejes për mbajtjen e armës, përcaktohen me udhëzim të veçantë të Ministrit të Rendit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I
Pandeli Majko